

# AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “UJËSJELLËSI KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A” (UKBK)

Në mbështetje të ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe në zbatim të Vendimit Nr.11, datë 13.11.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, hartohet ky Akt Themelimi për themelimin e shoqërisë “Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz” SH.A (UKBK)

## Neni 1 Emërtimi dhe Themelimi

- 1.1.Emri Shoqërisë është “Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz” SH.A (UKBK)
- 1.2.Shoqëria ka formën e shoqërisë aksionare me një nivel.

## Neni 2 Objekti

2.1.Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

- a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

2.2.Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2.3.Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të asamblesë së aksionarëve.

## Neni 4 Selia



Selia e përkohshme e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “5 Maji”, pranë Medresesë, Tiranë.

## Neni 5 Kapitali

5.1Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 289,024,000 lekë, me vlerë 1000 lekë për aksion.

Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.

5.2Kapitali i shoqërisë është transferuar sipas Raportit dhe Marrëveshjes së ndarjes të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.



5.3 Të gjitha aksionet e shoqërisë Ujësjetllësi Kanalizime Bashkia Kamëz” janë aksione të zakonshme. Asambleja e Aksionarëve, me vendim unanim, mund të vendosë për emetimin e aksioneve të ndryshme nga ato të zakonshmet. Vendimi për emetimin e aksioneve përcakton sasinë e aksioneve si dhe tagrat e tyre.

5.4 Aksionet zotërohen nga aksionari i vetëm Bashkia Kamëz – 100%

## **Neni 6 Organet e Shoqërisë**

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- a. Asambleja e Aksionarëve;
  - b. Këshilli i Administrimit

## **Neni 7 Anëtarët e Këshillit të parë të Administrimit**

1. Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët do të mbajnë këtë detyrë deri në mbledhjen e parë të Asamblesë të shoqërisë Ujësjetllësi Kanalizime Bashkia Kamëz” SH.A (UKBK).

2. Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë:

- Mariglen Qato në cilësinë edhe të Administratorit
- Elvin Tivari anëtar
- Kostandin Mato anëtar

## **Neni 8 Administratori**

Aministrator i parë i përkohshëm i Shoqërisë për një periudhë deri në mbledhjen e parë, të thirrur të Asamblesë të shoqërisë Ujësjetllësi Kanalizime Bashkia Kamëz” SH.A (UKBK) është Z. Mariglen Qato.

## **Neni 9 Ekspertët e emëruar kontabël**

Ekspert kontabël i përkohshëm i Shoqërisë është : “Mazars” shpk dhe person fizik Sokol Toska.

## **Neni 10 Shpenzimet e themelimit**

Shpenzimet për hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Themelimi ashtu si dhe të gjitha shpenzimet për njohjen ligjore dhe rregjistrimin e Shoqërisë janë në ngarkim të kësaj të fundit.

## **Neni 11 Hartimi**

Ky akt themelimi u hartua në 3 (tre) kopje të gjitha në gjuhën shqipe, nga të cilat një kopje mbahet nga Shoqëria ndërsa të tjerat do të depozitohen pranë organeve kompetente.

